



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 33/2024 regjistër (JR)
Datë 04.09.2024

Nr. 22 i vendimit
Datë 27.02.2026

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 27.02.2026, ditën e premte, ora 11:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me Sekretar Gjyqësor Kevin Kovaçica, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Komisionerja Publike Irena Nino.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 766, datë 22.05.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit z. Ervin Aliu, me funksionin ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5, e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), pasi u njoh me parashtrimet e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, të paraqitura nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar prej tij, z. Adnan Xholi, i cili deklaroi heqjen dorë nga ankimi objekt shqyrtimi, si edhe me kërkesën e subjektit dhe avokatit të tij, Julian Mërtiri, i cili kërkoi

pranimin e kërkesës të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme për heqjen dorë nga gjykimi dhe pushimin e çështjes, dëgjoi gjyqtaren relatores Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Ervin Aliu (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), me detyrë ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në bazë të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pika 4, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “AKSIK”), dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), sipas të cilave:

2.1. ILDKPKI, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se¹ :

- (i) Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- (ii) Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- (iii) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- (iv) Nuk ka kryer deklarim të rremë;
- (v) Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Ervin Aliu nëpërmjet verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Në përfundim të procesit verifikues, ka dërguar raportin e hartuar për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me konstatimin *për përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës*².

2.3. KLGj-ja, ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit Ervin Aliu gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, dhe duke përzgjedhur 5 (pesë) dokumente të tjera ligjore, sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm³ dhe të arsyetuar për të.

3. Komisioni, pasi kreu hetimin administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, arriti në konkluzionet si më poshtë.

3.1. *Për kriterin e vlerësimit të pasurisë*: Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

3.2. *Për kriterin e kontrollit të figurës*: Subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

¹ Raporti i ILDKPKI-së me shkresën nr. {***} prot., datë 18.4.2018.

² Raporti mbi kontrollin e figurës me nr. {***} prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim nr. {***}, datë 24.10.2023, të KDZH-së.

³ Raporti për analizimin e aftësive profesionale me nr. {***} prot., datë 17.2.2023.

3.3. *Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:* Subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është efektiv dhe eficient në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, sipas parashikimeve të nenit 44, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, u vlerësua “i aftë” për këtë kriter.

4. Në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar, Komisioni, me vendimin nr. 766, datë 22.05.2024, me shumicë votash, ka vendosur: *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Aliu, ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.*

II. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik

5. Kundër vendimit të Komisionit, ka ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “*Kolegji*”), Komisionerja Publike Irena Nino, duke paraqitur shkaqe ankimore, në drejtim të: **(i)** Mosdeklarimit nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* si pasuri në përdorim, të apartamentit me sipërfaqe 58.84 m², me adresë Lagjja “{***}”, Rruga “{***}”, Tiranë; **(ii)** Posedimit dhe përdorimit nga subjekti i rivlerësimit për disa vite, i automjetit tip “Mercedes Benz”, me targa {***}, pa leje qarkullimi, të paregjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, si dhe pa paguar detyrimet doganore; **(iii)** Mosdeklarimit të burimit faktik të krijimit të pasurisë automjet tip “Mercedes Benz”, me targa {***}, duke u përpjekur të paraqesë ndryshe situatën lidhur me krijimin e tij; si dhe **(iv)** Deklarimit të pasaktë dhe kontradiktor, lidhur me burimin e krijimit të depozitës bankare, pranë Bankës Kombëtare Tregtare (në vijim “BKT”), datë 05.08.2015, në shumën 220.000 lekë, si dhe mosdeklarimit të shlyerjes së huasë shtetasit S. M., në shumën 500.000 lekë, në vitin 2014 dhe burimit të të ardhurave për shlyerjen e kësaj shume, si rrethana, të cilat të vlerësuara sipas nenit 4, pika 2, e ligjit nr. 84/2016, tregojnë për një qasje të subjektit të rivlerësimit që e vendosin këtë të fundit në kushtet e zbatimit të nenit 61, pika 5 e këtij ligji.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

(a) Juridiksioni i Kolegjit

6. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë (në vijim “*Kushtetuta*”) dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin nga Komisioneri Publik të një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

(b) Legjitimimi i ankuesit

7. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr.84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit, brenda afatit ligjor prej 15

ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

(c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes

8. Shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit nr. 766, datë 22.05.2024, të Komisionit, duke qenë se është ushtruar nga Komisioneri Publik, u zhvillua në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
9. Në seancën gjyqësore publike të datës 27.02.2026, në zbatim të përcaktimeve të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe nenit 199, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues vendosi kalimin procedural të ankuesit nga Komisioneri Publik te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, z. Klodjan Braho, i cili u përfaqësua në gjykim nga z. Adnan Xholi, sipas tagrave të përfaqësimit të pasqyruara në autorizimin nr. {***} prot., datë 23.02.2026.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me kërkesën për heqjen dorë nga ankimi

10. Në seancën gjyqësore të caktuar për gjykimin e çështjes, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, në parashtrimet hyrëse të gjykimit, analizoi shkaqet e ankimit dhe parashtoi vlerësimin e tij në raport me to, duke konkluduar në mënyrë të përmblodhur se:

1. Lidhur me adresat e banimit dhe përdorimin e pasurisë “Apartament me sipërfaqe 58.84 m²”, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, çmon se megjithëse gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar si adresë banimi apo të drejtën e përdorimit të pasurisë “Apartament me sipërfaqe 58.84 m²”, për sa kohë nuk provohet se kjo pasuri ka qenë në përdorim të subjektit në kohën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë vetting dhe për sa kohë duket se kjo pasuri ka qenë në pronësi individuale të nënës së subjektit kohë përpara se subjekti të emërohej si ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, kjo pasaktësi nuk vlerësohet se mund të prodhojë në mënyrë proporcionale vendosjen e masës së shkarkimit nga detyra, si një masë e nevojshme për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj, për rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

*2. Lidhur me automjetin tip “Mercedes Benz”, me targa {***}, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, çmon se mospërmbushja e detyrimeve ligjore që lidhen me përdorimin apo regjistrimin e automjeteve në territorin e Republikës së Shqipërisë, parashikohet si masë administrative me gjobë dhe përgjegjësi disiplinore në kuadër të procesit të rivlerësimit gjendet e pazbatueshme kur nuk përbën një mënyrë sjellje të subjektit të rivlerësimit. Në rastin konkret, kur sjellja e subjektit të rivlerësimit kufizohet në mosregjistrimin e automjetit dhe mospagimin e detyrimeve doganore, vetëm në një rast, çmojmë se kjo rrethanë nuk është e mjaftueshme për të pasjellë marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.*

*3. Lidhur me automjetin tip “Mercedes Benz”, me targa {***}, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në konsideratë edhe të jurisprudencës të konsoliduar të Kolegjit, vlerëson se pasaktësitë e konstatuara në deklarin e burimit të krijimit të pasurisë automjet tip “Mercedes Benz”, me targa {***}, në kushtet kur nuk shoqërohen me pamjaftueshmëri të burimit të krijimit, nuk janë të tilla që të pasjellin marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.*

4. Lidhur me konstatimet mbi depozitën bankare pranë BKT-së, në shumën 220.000 lekë, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, vlerëson se ato i referohen rrethanave të ndodhura në një periudhë kohore

përpara se z. Ervin Aliu të emërohej në detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Në këto kushte, megjithëse konstatohet një pasaktësi në deklaratën e pasurisë për vitin 2014, lidhur me mosdeklarimin e shlyerjes ndaj shtetasit S.M, dhe burimit të fondeve përkatëse, kjo pasaktësi e pashoqëruar me pamjaftueshmëri nuk vlerësohet e një niveli të tillë sa të justifikojë, në mënyrë proporcionale, aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

11. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe nenit 463 të Kodit të Procedurës Civile, i ndryshuar, ka vendosur heqjen dorë nga ankimi i paraqitur nga Komisioneri Publik ndaj vendimit nr. 766, datë 22.05.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhënë për subjektin e rivlerësimit Ervin Aliu.
12. Subjekti i rivlerësimit dhe përfaqësuesi i tij, pasi u njohën me deklarimin për heqje dorë nga ankimi të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, përfundimisht kërkuan të pranohet kërkesa për heqje dorë, pasi nuk ka më lëndë procedurale për të vazhduar çështjen dhe të vendoset pushimi i çështjes.
13. Trupi gjykues, pasi është njohur me ankimin e paraqitur nga Komisionerja Publike kundër vendimit nr. 766, datë 22.05.2024, të Komisionit, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Ervin Aliu, parashtrimet me shkrim të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në të cilat deklaroi se ka vendosur të heqë dorë nga ankimi, si dhe kërkesën përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, vlerëson se:
14. Kushtetuta, në nenin 179/b, pika 5 e saj, parashikon se: *Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese [...] dhe, sipas kësaj dispozite kushtetuese, janë subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik ata që vënë në lëvizje Kolegjin e Posaçëm të Apelit, për kontrollin e vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbi bazën e ankimit të paraqitur prej tyre.*
15. Neni 179/b, pika 10 e Kushtetutës parashikon se procedurat dhe kriteret e rivlerësimit rregullohen sipas parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
16. Në nenin F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, parashikohet se: *Ndaj vendimeve të Komisionit mund të ushtrojnë ankim pranë këtij Kolegji subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, sipas ligjit, me përjashtim të vendimeve të marra, sipas nenit E, paragrafi 2 i Aneksit.* Në referencë të këtyre dispozitave kushtetuese, sidomos parashikimeve në nenin 179/b, pika 10 e Kushtetutës, trupi gjykues çmon se mjeti procedural i heqjes dorë nga ankimi, i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në kuadër të procesit të rivlerësimit, do të rregullohet sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.
17. Ndonëse në dispozitat e veçanta të ligjit nr. 84/2016, nuk gjenden rregullime të posaçme për t'i dhënë zgjidhje një situatë si kjo e rastit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vëren se në nenin 4, pika 6 e këtij ligji parashikohet se: *Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.*
18. Në kushtet kur si Kushtetuta edhe ligji nr. 84/2016 nuk i rregullojnë drejtpërdrejt procedurat në lidhje me institutin e heqjes dorë nga ankimi, në referencë të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative

dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, konkretisht të nenit 1, pika 2, ku parashikohet se: *Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe*, dhe të nenit 44 të tij, në të cilin parashikohet se: *Mjetet dhe afatet e ankimit të vendimeve të gjykatave administrative janë të njëjta me ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj* – trupi gjykues çmon se për të zgjidhur situatën konkrete duhet t’u referohet dispozitave të posaçme të Kodit të Procedurës Civile, që rregullojnë institutin e heqjes dorë nga ankimi dhe pasojat ligjore që prodhon ushtrimi i kësaj të drejte të ankuesit.

19. Sa më sipër parashtruar, në konsideratë të deklarimit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme se heq dorë nga ankimi i paraqitur nga Komisioneri Publik kundër vendimit nr. 766, datë 22.05.2024⁴, të Komisionit, në zbatim të parimit se ankuesi, statusin procedural të të cilit e ka fituar Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, për shkak të kalimit procedural, është dhe mbetet titullari dhe disponuesi i vetëm i mjetit procedural për të kundërshtuar vendimet e Komisionit në Kolegj, trupi gjykues vlerëson se gjendet para zbatimit të detyrueshëm të nenit 463 të Kodit të Procedurës Civile, në të cilin parashikohet pasoja ligjore e heqjes dorë nga ankimi, sipas këtij përcaktimi: *Në çdo fazë të gjykimit të çështjes në apel, ankuesi ose përfaqësuesi i tij mund të heqë dorë nga ankimi. Në këtë rast, vendoset pushimi i shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Apelit.*
20. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se vetë Kolegji nuk ka më lëndë procedurale për të shqyrtuar çështjen për të cilën është vënë në lëvizje dhe, në zbatim të dispozitës së cituar më lart, duhet të pushojë shqyrtimin e kësaj çështjeje në këtë fazë të procesit. Trupi gjykues sjell në vëmendje jurisprudencën e Kolegjit, e cila ka pranuar referimet për zgjidhjen e çështjes në rastin e heqjes dorë nga ankimi të paraqitur prej palës ankuese, pikërisht në dispozitat e cituara më lart.
21. Në këtë kuptim, duke ndjekur të njëjtën logjikë referuese, atë të dispozitave të cituara më lart, trupi gjykues, konstaton se vendimi nr. 766, datë 22.05.2024, i Komisionit, ndaj të cilit ishte ushtruar ankim, prej të cilit u hoq dorë nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në ushtrim të funksioneve të Komisionerit Publik, do të konsiderohet se merr formë të prerë në momentin që Kolegji merr vendimin për pushimin e shqyrtimit të kësaj çështjeje. Këtë situatë ligjore e rregullon qartësisht parashikimi i nenit 451, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Civile, e cila përcakton se: *Vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur nuk është bërë ankim kundër tij brenda afateve të caktuara nga ligji ose kur ankesa është tërhequr.*
22. Përfundimisht, trupi gjykues vlerësoi se, për shkak të heqjes dorë nga ankimi prej ankuesit, shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit duhet të pushohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenin 451, shkronja “b” e nenin 463 të Kodit të Procedurës Civile,

⁴ Të cilat janë të njëjta me parashtrimet me shkrim të nënshkruara prej tij e të administruara në Kolegj me shkresën nr. {***} prot., datë 23.02.2026.

VENDOSI:

1. Pushimin e shqyrtimit të çështjes (JR) nr. 33, datë 04.09.2024, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 766, datë 22.05.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Ervin Aliu.

2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 27.02.2026.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e relatores së çështjes (JR) nr. 33/2024, vlerësova të dalë në mendim paralel lidhur me vendimin nr. 22 (JR), datë 27.02.2026 të Kolegjit në të cilën është disponuar: *“Pushimi i shqyrtimit të çështjes (JR) nr. 33/2024 në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 766, datë 22.05.2024 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Ervin Aliu”*, për të qartësuar qëndrimin tim, lidhur me procedurën të ndjekur tashmë në Kolegj, në rastet e heqjes dorë nga ankimi.
2. Në koherencë me qëndrimin që kam mbajtur në vendimin nr. 5 (JR), datë 20.01.2026 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, K. M., në të cilin jam dakordësuar me vendimmarrjen e shumicës së trupit gjykues për pushimin e shqyrtimit të çështjes, edhe në rastin konkret që i përket çështjes së subjektit të rivlerësimit Ervin Aliu, vlerësoj të disponohet në të njëjtën mënyrë, pasi këto kanë qenë të vetmet çështje të regjistruara për shqyrtim në Kolegj, në të cilat pala në proces, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme hoqi dorë nga ankimi në një fazë të tillë procedurale, kur nuk ishte paraqitur asnjë kërkesë për çeljen e hetimit gjyqësor dhe kur çështja nuk i ishte nënshtruar ende debatit gjyqësor.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi